



Numër 112/02-6896

**RAPORT MBI PROCESIN E HARTIMIT TË AKTIT FILLESTAR TË RREGULLORES PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR.110/04-41197/2019 PËR ORARIN E PUNËS SË VEPRIMTARIVE EKONOMIKE NË KOMUNËN E GJAKOVËS.**

Me datën 18.03.2022 është nxjerr Vendimi me numër 112/02-6896 përmes së cilit Kryetari i Komunës së Gjakovës ka formuar grupin punues për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.110/04-41197/2019 për Orarin e punës së veprimtarive ekonomike në Komunën e Gjakovës.

Me datën 29.03.2022 grupi punues ka hartuar projekt aktin fillestar i cili i është dërguar për konsultim të brendshëm, drejtorit të Drejtorisë për Punë Inspektuese, drejtorit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Udhëheqësit të Sektorit Ligjor, Udhëheqëses të Sektorit për të Drejta të Njeriut dhe Barazi Gjinore, Udhëheqësit të Sektorit për Integritet Evropian dhe Udhëheqësit të Sektorit për Komunitete dhe Kthim.

Meqenëse nuk kishte propozime nga njësitë brenda Komunës, akti fillestar me datën 05.05.2022 është publikuar në ueb faqen e Komunës së Gjakovës, po ashtu është publikuar edhe njoftimi për konsultim publik me numër 112/02-6896 dhe kopja fizike e aktit fillestar të cilën qytetarët kanë mundur ta sigurojnë në zyrën informative për qytetarët në objektin e Komunës së Gjakovës çdo ditë pune prej orës 10:00 deri në ora 14:00, duke filluar nga data 05.05.2022, si dhe në ueb faqen e Komunës së Gjakovës.

Takimi me qytetarë i parapare me datën 10.06.2022 në ora 09:00 është mbyllur në ora 09:30 për shkak se nuk kishte pjesëmarrje të qytetarëve të interesuar.

Për aq sa u tha me lartë, në cilësinë e kryesuesit të grupit punës ju dërgoj në kompetencën tuaj për procedura të mëtutjeshme Draft Rregulloren për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.110/04-41197/2019 për Orarin e punës së veprimtarive ekonomike në Komunën e Gjakovës.

Artan Hoxha  
Kryesuesi i grupit punues